



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 95

2003

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.3962 datë 10.9.2003	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	4175
Dekret nr.3994 datë 3.11.2003	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	4176
Dekret nr.4012 datë 20.11.2003	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Vergo, rrethi Delvinë.....	4177
Vendim i GJK nr.32, datë 24.11.2003	Me objekt shfuqizimin e nenit 134 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenit 83 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, si antikushtetuese.....	4177
Vendim i GJK nr.33, datë 24.11.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.180, datë 24.9.2002 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr.4, datë 7.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	4180

DEKRET
Nr.3962, datë 10.9.2003

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|--|
| 1. Andon Petro Berxholi | 29. Arben Mustafa Hajdari |
| 2. Erifili Vangjel Vasili-Berxholi | 30. Roksana Agim Kavaja Houge |
| 3. Meliha Hysen Domi | 31. Lumturiye Halil Kulheku (Pilkati) |
| 4. Emiliano Stilian Caca | 32. Ndrëçim (Ndrëcim) Muhamet Hyska |
| 5. Tefta Abdurrahman Alikaj | 33. Lucinda Ndrëçim Hyska |
| 6. Luljeta Qemal Höfner (Zerdelia) | 34. Klaudia (Claudia) Kamber Gemein (Koçi) |
| 7. Agron Sadik Muca | 35. Anila Dhimitër Hunnemeyer-Shuqja |
| 8. Behexhet Namik Hydi | 36. Ermira Çezar Mezini |
| 9. Elfriede Maria Behexhet Hydi | 37. Shpëtim Kostandin Topuzi |
| 10. Alketa Petrit Hydi (Koçiaj) | 38. Diana Haxhi Dauer (Kurtalia) |
| 11. Amarildo Luigj Shqalsi | 39. Bardhyl Muharrem Çitozi |
| 12. Erinda Selami Baxhaja | 40. Alba Bardhyl Çitozi |
| 13. Ilirjan Nexhmedin Nenaj | 41. Ideal Bardhyl Çitozi |
| 14. Neriman Rexhep Nenaj (Gostivari) | 42. Aleksandra Hysen Kola (Çitozi) |
| 15. Admira Ilirjan Nenaj | 43. Eva Bajram Morava (Sena) |
| 16. Kledi Ilirjan Nenaj | 44. Sem Sokol Morava |
| 17. Arianisa Viron Tsogas (Naqe) | 45. Ines Sokol Morava |
| 18. Pranvera Qazim Belliu (Mair) | 46. Gani Nevruz Osmani |
| 19. Erjon Shkëlqim Krasniqi | 47. Bianka Avdurrahman Osmani (Bullati) |
| 20. Adrian Selim Çaçi | 48. Edinja Gani Osmani |
| 21. Zamir Adrian Çaçi | 49. Tahir Vexhi Uka |
| 22. Aida Gëzim Çaçi (Çarçani) | 50. Mateo Tahir Uka |
| 23. Elisabeta Selam Sundl (Hallkokondi) | 51. Miranda Hysen Uka (Iskurti) |
| 24. Gerhard Bato Sinella | 52. Matilda Tahir Uka |
| 25. Aida Pëllumb Trojer (Kurti) | 53. Gëzim Hasan Malko |
| 26. Hyrije Zenun Sturm (Ahmeti) | 54. Nisi Koço Vangjeli |
| 27. Spiro Demosten Muças | 55. Elvis Nisi Vangjeli |
| 28. Fatmir Qazim Krasniqi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.3994, datë 3.11.2003

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1. Rabiana Ali Ehrenstein (Katragjini) | 35. Chris Albert Korro |
| 2. Eva Bashkim Kraja (Zari) | 36. Tereza Albert Korro |
| 3. Diana Haxhi Meçani (Muja) | 37. Anila Elmas Korro (Kroj) |
| 4. Rovenë Gëzim Meçani | 38. Etleva Kujtim Muça (Pepellashi) |
| 5. Artilda Gëzim Meçani | 39. Florian Lulzim Muça |
| 6. Mirgen Gëzim Meçani | 40. Albert Xhemal Çiba |
| 7. Kujtim Ahmet Pazari | 41. Daniel Albert Çiba |
| 8. Arben Shuiap Shehu | 42. Dennis Albert Çiba |
| 9. Artan Mersin Domi | 43. Denada Muharem Çiba (Muka) |
| 10. Aurora Agim Koch (Rapo) | 44. Genci Kujtim Gjëbrea |
| 11. Simon Zef Noja | 45. Adnand Guri Ocelli |
| 12. Laura Simon Noja | 46. Armando Sadik Luga |
| 13. Iris Simon Noja | 47. Fierina Angjelin Tomasch (Karma) |
| 14. Irena Preng Noja (Uçi) | 48. Eridon Ibrahim Kraja |
| 15. Arben Ismail Vrap | 49. Baftjar Ymer Muhja |
| 16. Ina Arben Vrap | 50. Florika Ramadan Fejzoll |
| 17. Pamela Arben Vrap | 51. Merli Mentor Fallner (Lami) |
| 18. Alma Sulejman Vrap (Hoxha) | 52. Agron Feti Myftiu |
| 19. Xhirelda Arben Vrap | 53. Erida Mesehal Shkëmbi (Baci) |
| 20. Siada Fatmir Dosti | 54. Ajdiye Ymer Bisha (Bakalli) |
| 21. Eduard Hysni Mustafa | 55. Naureda Shpëtim Bisha |
| 22. Merita Asllan Rami | 56. Gjergj Zef Kola |
| 23. Adriatik Isuf Pataj | 57. Lea Emil Frenzke (Plumbi) |
| 24. Tahir Sherbet Qilafi | 58. Lorenz (Lorenc) Fatmir Bajrami |
| 25. Sonila Bajram Scherer (Këllezi) | 59. Olta Fatmir Bajrami |
| 26. Nancy Alfred Hoxha (Scherer) | 60. Alban Kadri Arapi |
| 27. Marsela Desara Hans Jörg Scherer | 61. Sokol Guçe Kucaj |
| 28. Fabio Sokol Delaj | 62. Matijas Sokol Kucaj |
| 29. Violeta Haki Meta | 63. Adnand Faruk Dragoti |
| 30. Vilson Kozma Ndreko | 64. Fatbardha Hair Troka |
| 31. Donika Nazif Dreni (Buchholz) | 65. Denis Arif Nuredini |
| 32. Mirjeta Ibrahim Lleshi | 66. Diana Genc Zajmi |
| 33. Jeton Rexhep Rustemi | 67. Ralf Lulëzim Demiri |
| 34. Albert Tosun Korro | 68. Dea Lulëzim Demiri |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4012, datë 20.11.2003

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE
NË KOMUNËN VERGO, RRETHI DELVINË

Në mbështetje të nenit 92 germa "gj" të Kushtetutës, si dhe të nenit 14, pika 5 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", bazuar në njoftimin e Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Vergo, rrethi Delvinë, të zhvillohen ditën e dielë, datë 7 dhjetor 2003.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.32, datë 24.11.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 18.7.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zotërinjtë Ilir Shurdhi e Gëzim Vleshnja, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

3. DREJTORIA E POLICISË NDËRTIMORE FIER, përfaqësuar nga zoti Alfred Kola, me autorizim.

4. KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT PRANË BASHKISË LUSHNJË, në mungesë.

5. ABDYL KORRESHI

6. BEDRI QORI E DRITAN CAKA, gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 134 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenit 83 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

Në kërkesë parashtrohen këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Dispozitat e kundërshtuara i heqin pushtetit gjyqësor të drejtën kushtetuese për të kontrolluar veprimtarinë administrative.

- Pezullimi i aktit administrativ lidhet me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.

- Preken dispozitat kushtetuese, si dhe protokollin shtesë i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me cenimin e pronës private.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e palëve dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 134 parashikon: "Asnjë urdhër administrativ ose vendim gjyqësor nuk mund të ndalojë ekzekutimin e akteve administrative, pavarësisht nga dispozitat ligjore për pezullimin e fuqisë së akteve”.

Kurse ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” në nenin 83 parashikon: “Ankimi në gjykatë kundër vendimeve të KRRT-ve, të organeve të Policisë Ndërtimore dhe të atyre të vënies së gjobave nuk pezullon ekzekutimin e tyre. Në rast se në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës vendoset pranimi i padisë ose i ankimit, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga organi që ka dhënë vendimin, shpërblimin për dëmin e shkaktuar”.

Të dyja këto dispozita të marra veçmas apo në lidhje me dispozitat e tjera të ligjeve përkatëse kanë të bëjnë me raportet midis organeve ekzekutive e atyre gjyqësore në fushën e akteve administrative.

Organet ekzekutive dhe administrative, në funksion të zbatimit të detyrave të tyre kushtetuese e ligjore kryejnë një veprimtari të gjerë e të shumanshme, si dhe një sërë veprimesh teknike, materiale e organizative.

Në këtë veprimtari me spektër të gjerë këto organe janë të pavaruara, pavarësi që garantohet nga Kushtetuta dhe ligji.

Në kryerjen e kësaj veprimtarie, organet e administratës janë në kontakt të vazhdueshëm e të përditshëm me individin, duke garantuar e plotësuar të drejtat e tij e duke siguruar njëkohësisht edhe përmbushjen prej tij të detyrimeve. Duke qenë se në fushën e veprimtarisë administrative realizohet kontakti më i shpeshtë e më i madh i shtetit me individin, është pikërisht kjo fushë që potencialisht përbën terrenin më të gjerë ku veprime e akte cenojnë interesat e ligjshme të qytetarëve.

Në bazë të nenit 15 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, janë të drejtat dhe liritë themelore ato elemente thelbësore që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik e që, për pasojë, diktojnë nevojën e kontrollit ndaj veprimtarisë së organeve të administratës. Dhe është pikërisht Kushtetuta, e cila në nenin 42/2 të saj garanton ndërhyrjen e pushtetit gjyqësor për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat kushtetuese dhe ligjore të individit.

Në një sërë dispozitash ligjore gjen të konkretizuar mundësinë e ndërhyrjes së pushtetit gjyqësor në mbrojtje të të drejtave e interesave të individit nga aktet e paligjshme apo të parregullta të administratës shtetërore, ku vendin kryesor e zë Kodi i Procedurës Civile, i cili në nenet 324-333 përmban kriteret e rregullat e shqyrtimit gjyqësor të këtyre akteve, duke pasur edhe përjashtimet përkatëse. Po kështu, në vetë Kodin e Procedurave Administrative (neni 18) është pranuar parimi i kontrollit gjyqësor të akteve administrative.

Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese konstaton se kontrolli gjyqësor ndaj akteve me karakter administrativ, duke qenë shprehje e parimit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve e duke qëndruar në themel të pavarësisë së organeve, ka ndryshime thelbësore nga kontrolli administrativ që kryhet në rrugë hierarkike apo nga organe të krijuara posaçërisht. Dallimet qëndrojnë, krahas të tjerave, në rrafshin procedural, në kuptim që gjykatat në kontrollin e këtyre akteve respektojnë rregullat

procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Ato nuk mund të interferojnë e as të adaptojnë procedura administrative. Ndër rregullat procedurale, rëndësi paraqet pezullimi i aktit objekt shqyrtimi nga gjykatat si një mundësi procedurale për të mënjeluar krijimin e pasojave negative nga një akt i kontestuar për kundërligjshmëri.

Pezullimi i aktit administrativ si një veprim procedural gjyqësor kushtëzohet nga një sërë elementesh që e bëjnë atë të dallueshëm nga pezullimi, si pasojë e ankimit administrativ. Në mënyrë të përmbledhur këto elemente janë: ngritja e padisë për shfuqizimin e aktit administrativ, akti administrativ duhet të jetë objekt shqyrtimi në referim të neneve 324-326 të Kodit të Procedurës Civile; në padi veç saj të jetë kërkuar shprehimisht pezullimi i zbatimit të aktit; të ekzistojnë argumente bindëse për gjykatën se zbatimi i aktit mund të shkaktojë pasoja të pariparueshme ose vështirësisht të riparueshme me rastin e një vendimi eventual që do të shfuqizonte aktin dhe, së fundi, vendimi gjyqësor për pezullim duhet të arsyetohet.

Duke analizuar dy dispozitat e kontestuar në kërkesë, në rrafshin e përfundimeve të arritura më lart, Gjykata Kushtetuese konstaton:

1. Neni 83 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” nuk vjen ndesh me Kushtetutën. Sipas nenit 18 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimtaria administrative i nënshtrohet kontrollit administrativ dhe kontrollit gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Sipas nenit 130 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative, aktet administrative mund të pezullohen edhe nga gjykata, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (kreu “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”).

Sikundër kuptohet nga përmbajtja e këtyre dy dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, jo vetëm që nuk përjashtohet kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë administrative (sikundër pretendohet në kërkesë), por as kufizohet gjykata në të drejtën e saj për pezullimin e akteve administrative, përderisa veprojnë rregullat e Kodit të Procedurës Civile.

Në nenin 83 të ligjit “Për urbanistikën” thuhet se ankimi në gjykatë kundër veprimeve të KKRT-së të organeve të Policisë Ndërtimore dhe të atyre të vënies së gjobave, nuk pezullon ekzekutimin e tyre. Kjo do të thotë që vetëm paraqitja e ankimit në gjykatë për këto vendime nuk shkakton automatikisht pezullimin e tyre. Por, kur pala e interesuar kërkon njëkohësisht edhe pezullimin e këtyre akteve, atëherë gjykata nuk ka asnjë pengesë që kur janë kushtet e nenit 329 të Kodit të Procedurës Civile të vendosë pezullimin e aktit të nxjerrë nga këto organe. I parë problemi në këtë këndvështrim, dispozita e nenit 83 të ligjit “Për urbanistikën” nuk e cenon kontrollin administrativ të gjykatës mbi veprimtarinë administrative dhe as është në kundërshtim me nenin 329 të Kodit të Procedurës Civile. Për këto arsye, kjo dispozitë nuk ka karakter antikushtetues dhe si e tillë nuk duhet të shfuqizohet.

2. Neni 134 i ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është antikushtetues e për rrjedhojë duhet të shfuqizohet.

- Së pari: Kodi ka për objekt përgjithësisht veprimtarinë e administratës publike e për pasojë rregullat e parashikuara nga ai nuk mund të shërbejnë për të interferuar në veprimtarinë e organeve që i përkasin pushtetit gjyqësor, duke cenuar në këtë mënyrë pavarësinë e tij të garantuar nga Kushtetuta.

- Së dyti: E drejta e pezullimit të aktit, objekt shqyrtimi gjyqësor, është një e drejtë që lidhet pazgjidhshmërisht me procesin e rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës. Të mënjanojnë pezullimin si një prerogativë e natyrshme e organeve gjyqësore në ushtrimin e pushtetit të tyre do të thotë të pengohet realizimi i një procesi të rregullt në parametrat që kërkon dispozita e mësipërme kushtetuese, ashtu dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

- Së treti: Mënjanimi në mënyrë arbitrare i kësaj kompetence të organeve gjyqësore në shqyrtimin e ankimeve ndaj ligjshmërisë së akteve të administratës publike vështirëson ose bën të pamundur efektivitetin e ankimit, kërkesë thelbësore që buron nga neni 13 i Konventës dhe nga neni 8 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

- Së katërti: Dispozita, edhe përsa i përket ndalimit të pezullimit të aktit si pasojë e urdhrave administrativë, krijon përplasje me dispozita të tjera të Kodit, duke shkaktuar moszbatimin e tyre e duke cenuar veprimtarinë e administratës publike që, në përgjithësi, në doktrinën e së drejtës kushtetuese është pranuar si jokushtetutshmëri. Kështu, ndërsa dispozita e atakuar përjashton

pezullimin në rrugë administrative të aktit me karakter administrativ, neni 131 i Kodit parashikon kompetencën pezulluese të organeve të larta që kanë të drejtë të shfuqizojnë aktet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, si dhe neneve 49-51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 134 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

- Rrëzimin e kërkesës lidhur me kushtetutshmërinë e nenit 83 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.33, datë 24.11.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 6.10.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.34 Akti që i përket:

KËRKUES: BLEDAR YZEIRI, përfaqësuar nga avokat Eduard Veçani, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.180, datë 24.9.2002 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.4, datë 7.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në kërkesë ngrihet si shkak:

- Në gjykimin në apel ka munguar kërkuesi, si dhe avokati për shkak të reshjeve të jashtëzakonshme, fakt i njohur botërisht.

- Pavarësisht nga këto shkaqe me karakter objektiv, gjykata e apelit ka qenë e detyruar të caktonte një avokat për të realizuar mbrojtjen.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.186, datë 27.6.2002, ka deklaruar fajtor kërkuesin Bledar Yzeiri për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe armëmbajtje pa leje dhe e ka dënuar përfundimisht me 17 vjet burgim.

Mbi ankimin e të pandehurit, Gjykata e Apelit Vlorë ka shqyrtuar çështjen dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit me vendimin nr.180, datë 24.9.2002. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit nuk ka pranuar rekursin; me arsyetimin se ai është paraqitur nga një subjekt i palegjitimuar (neni 420/a i Kodit të Procedurës Penale).

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, si dhe ato të paraqitura në gjykim, Gjykata Kushtetuese vëren se Gjykata e Apelit Vlorë ka bërë njoftime me shkrim për kërkuesin dhe avokatin e tij për gjykimin e datës 24.9.2002. Këto njoftime janë marrë përkatësisht nga nëna e kërkuesit, e cila ka bërë shënimin se Bledar Yzeiri ndodhej jashtë shtetit, si dhe nga avokati. Në procesverbalin e seancës gjyqësore është fiksuar fakti i njoftimit, ashtu si dhe konstatimi i mosparaqitjes. Në procesverbal është pasqyruar edhe fakti i mosmarrjes së vendimit për shqyrtimin e çështjes në mungesë, me arsyetimin se i pandehuri dhe avokati kanë dijeni dhe pa shkaqe ligjore nuk janë paraqitur.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, lidhur me mospjesëmarrjen, si shkak është ngritur fakti i reshjeve të mëdha që bënë të pamundur komunikimin Fier-Vlorë, fakt që sipas kërkuesit është i njohur botërisht.

Në tërësinë e këtyre të dhënave, Gjykata Kushtetuese eidenton si një fakt thelbësor në favor të kërkesës atë që gjykimi në gjykatën e apelit, duke qenë se i pandehuri ishte në mungesë, u zhvillua pa pjesëmarrjen e mbrojtësit të të pandehurit, duke mos realizuar minimumin e domosdoshëm të mbrojtjes së të drejtave të të pandehurit në një proces penal, pranuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese si një ndër kushtet esenciale për një gjykim të rregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese, në mënyrë konstante, në një sërë vendimesh ka pranuar si tregues esencial të një procesi të rregullt penal ekzistencën e mbrojtjes. “Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që, në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësve në gjykim, por dhe t’i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve”.¹ Në këtë drejtim ka ecur edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Në një çështje ajo pranon: “E drejta e gjithkujt të akuzuar penalisht për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore e një gjykimi të drejtë”.

Mungesa e një mbrojtjeje efektive në procesin penal ka lidhje të drejpërdrejtë me realizimin e parimit të kontradiktorialitetit si mjet efikas për zbulimin e së vërtetës, duke disponuar cilësisht edhe mjetet e barabarta.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Gjykata e Apelit Vlorë, qoftë edhe në pikëpamje formalo-juridike, nuk mund e nuk duhej të konsideronte të mjaftueshme konstatimin e mungesës së të pandehurit e të mbrojtësit, duke marrë një vendim e duke zhvilluar gjykimin në mungesë. Ajo duhej të merrte të gjitha masat e parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (nenet 348 e vijues) për të siguruar mbrojtjen e të pandehurit.

Në dallim nga procesi civil, procesi penal i shkallës së parë e të dytë, në referim të Kodit të Procedurës Penale, është konceptuar për çdo rast si proces që zhvillohet me mbrojtës, të cilin, në raste të caktuara nga ligji, nuk përjashtohet ta caktojë edhe vetë gjykata. Kjo për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme që ka në një shtet demokratik garantimi i lirisë së personit nga çdo prekje.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

¹ Vendimi nr.5, datë 17.2.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.180, datë 24.9.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.4, datë 7.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 27.11.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë